

ABSTRAKTI I TEMËS

“Kontratat në të drejtën romake dhe zhvillimi i tyre në të drejtën pozitive”.

1. Arsyeshmëria e studimit të kësaj teme

Përmes shtjellimit të kësaj teme dëshiroj të kontribuoj në kuptimin e përgjithshëm se si dhe pse ligji zhvillohet që nga koha e të drejtës romake dhe të shpjegoj evolucionin e disa institucioneve ligjore të njohura. Po ashtu dua të shtoj njohurinë tonë për historinë e ligjit romak, duke prodhuar pikëpamje të ndryshme të zhvillimit të kontratave, që janë në përputhje me të dhënat e mbijetuara tekstuale dhe të besueshme për sa i përket sjelljeve të njeriut. Sistemi juridik romak ka ndikuar në formimin e parimeve themelore të së drejtës. Koncepte si pronësia, kontratat, obligacionet, përgjegjësia civile, kanë qenë thelbësore në sistemin juridik romak dhe kanë qenë përmbajtja e së drejtës romake. Studimi i këtyre parimeve ofron një bazë solide për të kuptuar sistemet juridike të sotme.

E drejta romake ka qenë sistemi më përparimtar dhe më i kopjuar në të drejtën pozitive; pjesa që ka rregulluar kontratën ishte pjesa më origjinale dhe më e admiruar e atij sistemi. Marrëveshjet private dhe ligji në fuqi zënë një rol qendror në vendet tregtare, apo me mirë të themi në botën perëndimore në përgjithësi dhe se kjo ka ndikuar dhe ndikon ende në zhvillimin ekonomik dhe ligjor në shoqëri. Kjo pasi që një kontratë është një marrëveshje private, pothuajse një ligj privat, që vepron midis dy individëve, por që kërkojnë njohje nga shteti.

Sot, e drejta romake nuk zbatohet më në praktikën ligjore, edhe pse sistemet ligjore të disa vendeve si Afrika e Jugut dhe San Marino ende bazohen në jus commune. Sidoqoftë, edhe kur praktika ligjore bazohet në një kod, zbatohen shumë rregulla që rrjedhin nga ligji romak: asnjë kod nuk është thyer plotësisht me traditën romake. Përkundrazi, dispozitat e të drejtës romake janë përshtatur në një sistem më koherent dhe të shprehur në gjuhën kombëtare. Për këtë arsye, njohja e të drejtës romake është e domosdoshme për të kuptuar sistemet ligjore të sotme. Në studim do të analizohen dhe interpretohen **Parimet për Kontratat Tregtare Ndërkombëtare -UNIDROIT (PICC) dhe Parimet e të Drejtës Kontraktore Evropiane (PECL)**, dhe instrumentet e tilla si: Drafti i Kornizës së Përbashkët të Referencës (DCFR), Ligji i Përbashkët Evropian i Shitjeve (CESL), Parimet PAVIA, apo Direktiva të BE-së, që lidhen me këtë fushë studimi. Realizimi i këtij studimi përbën përpjekjen në trajtimin e ndikimit të drejtës romake gjegjësisht të kontratave edhe në të drejtën evropiane si bazë për unifikim - harmonizim dhe në të drejtën pozitive në përgjithësi.

Si hapa drejt një unifikimi të së drejtës private në shtetet anëtare të Bashkimit European po merret jus commune, e cila ishte baza e përbashkët e praktikës ligjore kudo në Evropë, por e përshtatur për shumë variante lokale. Bashkëpunimi ka filluar së pari në fushën e tregtisë dhe medoemos ka kërkuar ndryshime administrative dhe më pas edhe ndryshime ligjore. Rritja në vazhdim e tregtisë dhe migrimit të banorëve kanë kërkuar një bashkëpunim ndërmjet shteteve edhe në fushat e tjera, duke mos u përjashtuar as gjyqësia.

E drejta kontraktore duke qenë e hershme, është krejtësisht e bazuar nga parimet e të së Drejtës Romake dhe ka pasur rëndësi në rregullimin e praktikave të shkëmbimit, marrëveshjeve dhe tregtisë. Në Kosovë, legjislacioni civil është i frymëzuar nga tradita ligjore të vendeve, të cilat i përkasin traditës kontinentale të njohur si Civil Law.

Njëherit duke synuar që tema të jetë sa më racionale dhe që të trajtohet kjo fushë në aspektin shumë dimensional jam përcaktuar që të trajtoj **“Kontratat në të drejtën romake dhe zhvillimi i tyre në të drejtën pozitive”**.

Në pjesën e parë do të paraqes historikun e drejtës romake dhe ndikimi i saj në të drejtën kontraktuese. Pjesa e dytë përqendrohet në llojet e koncepteve dhe kontrata në të drejtën romake me theks të veçantë: Kontratat konsesuale, Pjesa e tretë në historikun e shkurtër të lindjes së idesë dhe punës së bërë për parimet e së drejtës kontraktuese evropiane nga ndikimi i të drejtës romake. Problemi i harmonizimit të së drejtës civile në të drejtën Evropiane e ka zgjuar interesin e shumë profesorëve, studiuesve dhe institucioneve evropiane. *Ole Lando vë në dukje se, "ekzistimi i ligjeve të ndryshme lidhur me të drejtën kontraktuese në Evropë mund të konsiderohet si një pengesë jo-tarifore e tregtisë”¹.*

Rregullat e ndryshme të së drejtës kontraktuese në shtetet anëtare krijojnë pengesa në shfrytëzimin e tregut të brendshëm dhe çojnë deri te konkurrenca jo e shëndoshë. Pas shumë debateve Bashkimi Evropian është i vetëdijshëm se një nga pengesat për harmonizim është mungesa e terminologjisë juridike uniforme, e cila pengon çdo lloj të bashkimit dhe harmonizimit të së drejtës civile evropiane. Në pajtim me parimin e barazisë gjuhësore, Komuniteti Evropian (KE), parasheh që të gjitha dokumentet ligjore duhet të përpilohen dhe publikohen në të gjitha gjuhët zyrtare të shteteve anëtare.

2. Metodatat e punës

Kërkimi dhe përzgjedhja e literaturës është bërë duke siguruar materialet (libra, artikuj shkencorë, monografi, vendime gjykatash, punime shkencore, të prezantuara në konferenca shkencore), të cilat janë përzgjedhur me kujdes për të qenë materiale cilësore dhe me vlerë. Prandaj, jam përpjekur që gjatë studimit t'i referohem emrave të njohur të studiuesve të huaj dhe shtëpive botuese me emër.

Metoda përshkruese, të cilën e kam parë të nevojshme ta përdorë për të treguar e sqaruar, nëpërmjet një trajtimi historik e kronologjik, zhvillimin e të drejtës kontraktore në të Drejtës Romake dhe evoluimin e mëtejshëm të saj dhe përfshirjen e saj në Kodifikimet e para evropiane. Metoda përshkruese është përdorur në shërbim të sqarimit të kuptimit të koncepteve të kontratave, si dhe formave në të cilat shfaqen.

Metoda analizuuese, është përdorur në analizimin e legjislacioneve të brendshme të shteteve të përzgjedhura për të qenë pjesë e studimit dhe disa instrumenteve me natyrë ndërkombëtare. Duke

¹ *Ole Lando, Optional or Mandatory Europeanization of Contract Laë, 8 EUR. REV. PRIV. L. 59, 61 (2000)*

mos u mjaftuar me metodologjinë tradicionale “black letter” janë analizuar dhe vlerësuar qëndrimet doktrinarë të studiuesve dhe praktikuesve të ligjit, për të cilat është rezervuar një hapësirë e konsiderueshme në këtë studim.

Metoda krahasuese është përdorur përkatësisht në dy drejtime: (1) midis dy traditave të së drejtës Civil Law dhe Common Law për të pikasur, identifikuar dhe vendosur në fokus dallimet kryesore në të Drejtën Kontraktore, të zhvilluara nga secila prej tyre dhe (2) brenda secilës traditë, nëpërmjet krahasimit të së Drejtës Kontraktore të disa shteteve. Metoda krahasuese është përdorur për të kuptuar edhe dallime të mundshme ndërmjet disa instrumenteve me natyrë ndërkombëtare. Ky krahasim, njëkohësisht i kryqëzuar ndërmjet dy traditave të së drejtës dhe më shumë legjislacioneve të brendshme, si dhe ndërmjet instrumenteve ndërkombëtare me natyrë të detyrueshme apo soft law, është shoqëruar me qëndrime të autorëve të ndryshëm.

Metoda interpretuese është përdorur për interpretimin sistematik të dispozitave ligjore të disa Kodeve Civile, por edhe të disa ligjeve të tjera, që kanë ndihmuar edhe në identifikimin e detyrimeve të palëve në një marrëdhënie kontraktore.

KANDIDATI:

Armend Hamiti

